

Vendim nr. 83 datë 18.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ANDON QAKO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1473, datë 21.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Rifillimi i hetimit penal ndaj gjyqtarës administrative për manipulimin e procesit dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në vitin 2016 ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar procedimin penal të një gjyqtareje dhe një sekretareje gjyqësore, që ushtronin detyrën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP). Kallëzimi penal lidhej me një çështje gjyqësore administrative me objekt shpërblimin e dëmit të kërkuesit për shkak të veprimeve të padrejta të Komisarariatit të Policisë nr. 6, Tiranë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila ka përfunduar me vendim për rrëzimin e padisë. Pas verifikimit të kallëzimit, prokurorja e çështjes ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale.

2. Kërkuesi e ka kundërshtuar vendimin e mosfillimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo e fundit, me vendimin nr. (11-2017-1255) 51/644, datë 13.03.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk ekzistojnë dyshime të arsyeshme për elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Sipas asaj gjykate, organi i akuzës ka kryer verifikime në aktet e dosjes gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ku ka rezultuar se veprimet e kryera nga ana e gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore gjatë procesit gjyqësor administrativ janë në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative. Po ashtu, sipas gjykatës së shkallës së parë, prokurorja e çështjes ka ushtruar kompetencat vendimmarrëse në bazë dhe zbatim të ligjit penal procedural, si dhe nuk ka kryer ndonjë veprim në kundërshtim me ligjin.

3. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 258 (10-2017-2264), datë 28.09.2017. Gjykata e apelit ka evidentuar, ndër të tjera, se sipas vendimit unifikues nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rastet e mosfillimit të procedimeve penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë, por mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta. Po sipas gjykatës së apelit, në aktet e kallëzimit nuk ka asnjë të dhënë të bazuar që nga subjektet e kallëzuara të jenë kryer veprime apo mosveprime që përbëjnë elementet e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i KP-së.

4. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1473, datë 21.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit e ka argumentuar vendimmarrjen e saj, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, të cilat janë parashtruar edhe në rekurs, si dhe nuk konstatohet të ketë shpërdorim detyre nga të kallëzuarat.

5. Në datën 13.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkua, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.02.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vendosur në kundërshtim me provat që u janë vënë në dispozicion, siç janë kërkesa e gjyqtares për heqjen dorë nga gjykimi, mospërdorimi i sistemit të regjistrimit audio, teksti i vendimit të gjyqtares, shkresa e një gjyqtari tjetër dhe komunikimi i kërkuesit me një gjyqtare tjetër, ku tregohet adresa e kërkuesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe formalisht ka interes në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin në shqyrtim Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 21.09.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 13.02.2024. Me anë të shkresës nr.1735/1, datë 08.04.2024, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi gjyqësor është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 27.12.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, si rrjedhim ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

12. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka identifikuar ndonjë të drejtë ose liri themelore të cenuar nga vendimet gjyqësore, por ka parashtruar se prokuroria dhe më pas gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në kundërshtim me provat e vëna në dispozicion prej tij, kanë nxjerrë përfundimin se vepra penale e kallëzuar nuk ekziston.

13. Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të fakteve dhe provave bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.